

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Vendosja / et-Temekkun / التَّمَكُّن

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"وَلَا يَسْتَخِفُّكَ الَّذِينَ لَا يُؤْفِقُونَ"

“Dhe le të të mos shqetësojnë¹ ata që nuk janë të bindur (në besim).” (er-Rum, 60)

Vendosja është përmbi *tuma'nineh* (Rehati) dhe i referohet kulmit të stabilitetit. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është vendosja e ndjekësit (të shtegut të pastrimit shpirtëror), që nënkupton:

- Qëllimin (nijetin) e saktë që e lëviz
- Shkëlqimin e dobët të të parit (*shuhud*) që e bart
- Gjerësinë e shtegut që i jep pushim²

Niveli i dytë është vendosja e udhëtarit (të shtegut të pastrimit shpirtëror), që nënkupton kombinimin e:

- Shkëputjes së njëmendtë³
- Shkreptimës së zbulimit

¹ Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës në arabisht është “të të bëjnë joserioz”, që po ashtu përkthehet si “të të bëjnë të lehtë nga mendja.” Kjo po ashtu mund të përkthehet si: të të bëjnë të paqëndrueshëm, të përkulshëm, të luhatur ose të pavendosur.

² Shtegu është i drejtë, por po ashtu i gjerë, gjë që i jep udhëtarit hapësirë për përtëritje dhe variacione të zgjedhjeve dytësore, të cilat çojnë drejt qëllimit të vetëm të tij.

³ Shkëputja nga *es-siwa* (çdo gjë tjetër përveç Allahut)

- Dhe dëlirësisë së gjendjes (*haal*)

Niveli i tretë është vendosja e 'arifit (njohësit të shtegut të pastrimit shpirtëror), që është:

- Arritja e pranisë (*el-hadrah*)⁴
- Përtej perdeve të kërkimit⁵
- Duke bartur dritën e realitetit⁶

⁴ Domethënë pranisë hyjnore.

⁵ Pasi të kesh tejkaluar të metat që shoqërojnë adhurimin para përpunimit të plotë të vetvetes (ose, sipas shejhut el-Harawi, shpërbërjes së plotë të vetvetes, duke qenë se ai konsideron *fana*-në fundin më të lartë). Siç është përmendur më herët, vetja ka nevojë të pastrohet për të qëndruar pranë Allahut, për Allahun, me Allahun. Shejhu mund të ketë menduar këtu se vetëdija që personi ka për adhurimin që bën mund të përbëjë një perde mes tij dhe Zotit, derisa të pushojë të ndiejë veten dhe t'i atribuojë ndonjë gjë.

⁶ *Wuxhuud* ose arrija e qëllimit të kërkuar - hyjnore.